VENDIM
Nr.501, datë 30.6.2005

PËR KRITERET E PËRFAQËSIMIT, TË PËRZGJEDHJES, EMËRIMIT, SHKARKIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kriteret e përfaqësimit, të përzgjedhjes, emërimit, shkarkimit dhe funksionimit të Këshillit të Statistikave, i cili përbëhet nga 11 anëtarë, të jenë:

1. Përbërja e Këshillit të Statistikave

Anëtarët e Këshillit të Statistikave, të cilët emërohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e zëvendëskryeministrit, përfaqësojnë institucionet kryesore dhe grupet e përfshira në nxjerrjen e statistikave zyrtare si më poshtë vijon:

- Agjencitë statistikore 5 anëtarë;
- Qarqet akademike dhe shkencore 3 anëtarë;
- Komuniteti i biznesit, shoqërisë civile dhe medias 3 anëtarë.

2. Kriteret e përzgjedhjes

a) Anëtarët duhet të jenë persona të kualifikuar nga fusha ekonomike e sociale, që kanë reputacion të spikatur, të jenë me aftësi dhe përvojë në fushën e statistikës, në atë ekonomike, sociale e mjedisore.

b) Anëtarët, në veprimtarinë e tyre, duhet të jenë të paanshëm dhe transparentë, të pavaruar politikisht, për zgjedhjen e teknikave sa më të përshtatshme në nxjerrjen e statistikave zyrtare.

3. Kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë e anëtarit

a) Anëtari i Këshillit të Statistikave emërohet për një periudhë shtatëvjeçare, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.

b) Mandati i anëtarit mbaron kur:

i) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

ii) nuk paraqitet në detyrë pa arsye më shumë se në tri mbledhje;

iii) jep dorëheqjen;

iv) deklarohet i paaftë për të vepruar, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

4. Zëvendësimi i anëtarit

Për rastet e mbarimit të mandatit, parashikuar në shkronjën "b" të pikës 3, zëvendësimi i anëtarit bëhet sipas procedurave të sipërpërmendura. Këshilli i Ministrave, me vendim, emëron anëtarin e ri, në bazë të propozimit të dhënë nga Këshilli i Statistikave.

5. Organet drejtuese

a) Organet drejtuese të Këshillit të Statistikave janë:

i) kryetari;

ii) zëvendëskryetari.

b) Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen nga anëtarët e Këshillit të Statistikave, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve.

Kryetari përfaqëson Këshillin e Statistikave në marrëdhënie me të tretët për vendimet që merr këshilli.

6. Mbledhja e Këshillit të Statistikave

a) Këshilli i Statistikave mblidhet në seancë të zakonshme të paktën një herë në vit, me kërkesë të kryetarit dhe në të duhet të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Këshilli mund të mblidhet në seanca të jashtëzakonshme kur e kërkon kryetari i këshillit ose të paktën 1/3 e anëtarëve të tij.

b) Anëtarët njoftohen me shkrim për datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet mbledhja, si dhe për rendin e ditës, që do të shqyrtohet në mbledhje. Si rregull, njoftimi bëhet të paktën 10 ditë përpara datës së mbledhjes. Për çështje urgjente kryetari i këshillit mund të thërrasë mbledhjen, duke mosrespektuar afatet e mësipërme, por, detyrimisht, me një njoftim me shkrim.

c) Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it merr pjesë në mbledhje, pa të drejtë vote.

7. Vendimet

Mbledhjet zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se 2/3 e anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Vendimet e Këshillit të Statistikave merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Në rast të votave të barabarta, vota e kryetarit është vendimtare.

8. Sekretariati

a) Shërbimi i sekretariatit sigurohet nga INSTAT-i.

b) Sekretariati i Këshillit përbëhet nga dy anëtarë, njëri nga INSTAT-i dhe tjetri nga Këshilli i Statistikave.

c) Detyrat e sekretariatit vendosen nga Këshilli i Statistikave, me vendim të veçantë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano